



KOMISIONI I PAVARUR PËR MEDIA  
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE  
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



## Vendim i Këshillit të KPM-së për Revokim të Vendimit CIMC 2007/2

Këshilli i KPM-së, i themeluar më 28 gusht 2006, në bazë të Nenit 7.7 të Ligjit mbi KPM-në, ka nxjerrë Rregullat e Procedurës (CIMC- 2006/2) në të cilat, me Nenin 5, ka përcaktuar edhe delegimin e përgjegjësive tek Shefi Ekzekutiv.

Ky Nen thotë:

*“Këshilli do të përcaktoj llojet e rasteve dhe kushtet nën të cilat e delegon të drejtën e marrjes së vendimeve tek Shefi Ekzekutiv. Kjo do të përfshijë rastet e thjeshta të natyrës rutinore si dhe mundësinë të zgjidhë rastet apo mbyllë rastet nëse nuk ka rrethana që këto raste të vazhdojnë. Këshilli do të rishikoj delegimin së paku një herë në vit.*

*Shefi Ekzekutiv apo ndonjë anëtarë i personelit i caktuar nga ai/ajo do të prezantoj një përmbledhje mbi rastet e tilla tek Këshilli në secilën mbledhje të Këshillit. Këshilli do të përcaktoj natyrën e saktë të përmbledhjes së tillë.”*

Këshilli i KPM-së në takimin e datës 9 maj 2008 ka rishikuar këtë vendim dhe ka vlerësuar që vendimi duhet të ndryshohet. Deri në sjelljen e vendimit të ri të ndryshuar, Këshilli ka vendosur që të revokojë Vendimin CIMC 2007/02.

Në emër të Këshillit të KPM-së.

Argjentina Grazhdani  
Kryesues e Këshillit të KPM-ës



Ref: 0805/0687/CIMC/ag  
Prishtinë, 12 maj 2008